

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e dytë shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik” është një nga projektet që duhet të ketë konsensusin e të gjithëve në këtë sallë, por edhe vetëdijesimin për rëndësinë e ratifikimit të këtij protokollit.

Që në krye të herës do të doja t’i tërhiqja vëmendjen e Shërbimit të Redaktimit në Kuvendin e Shqipërisë, sepse do të ishte me vend që titulli i protokollit të shkruhej korrekt. Pas shprehjes “krim kibernetik” do të duhej të vihej presje, sepse ka një konventë për krimin kibernetik, sikurse ka një protokoll, siç është protokollit që po diskutojmë, që garanton bashkëpunimin e zgjeruar dhe zbulimin e provave elektronike.

Konventa për Krimin Kibernetik është e hapur për nënshkrim që prej vitit 2001 dhe ne e kemi miratuar këtë konventë. Besoj se përgjigjja jonë për ratifikimin e protokollit të dytë shtesë të kësaj konvente është përgjigjja e duhur dhe vjen në kohë të shpejtë, pasi përgatitjet për protokollin e dytë shtesë të kësaj konvente janë relativisht të vona. Siç rezulton edhe nga teksti i protokollit të dytë shtesë të kësaj konvente, bëhet fjalë për një protokoll, hartimi i të cilit ka përfunduar në maj të vitit 2021.

Gjatë kësaj kohe kemi pasur shumë diskutime për sa u takon sulmeve kibernetike të organizuara nga hakerat iranianë ndaj shërbimeve që ofron AKSHI dhe më pas ndaj sistemeve që ka Ministria e Brendshme. Pavarësisht nga vlera e çdo diskutimi, besoj që këto diskutime kanë pasur një vlerë të përbashkët: të rrisin alarmin për të mbrojtur sistemet tona të komunikimit, që më së shumti përmbajnë të dhëna konfidenciale, të dhëna që i shërbejnë sigurisë kombëtare dhe të dhëna personale. Të tria këto kategori të dhënash, që në vetvete përfaqësojnë një fushë shumë të gjerë, meritojnë të mbrohen në nivelin e duhur dhe është detyrim i qeverisë që të ofrojë standardin më të mirë për mbrojtjen e këtyre sistemeve.

Gjatë këtyre diskutimeve dikush nga kolegët e opozitës pyeti çfarë reagimi ka pasur qeveria në rastin konkret. Unë besoj se ka pasur, të paktën në këtë kohë, dy përgjigje të rëndësishme në nivelin legjislativ, sepse janë propozuar dy projektligje të rëndësishme: projektligji “Për aderimin e në protokollin e dytë shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik” dhe projektligji “Për informacionin e klasifikuar”, projektligje që në gjykimin tim do të na ofrojnë mundësinë për politika që u përgjigjen standardeve bashkëkohore sa i takon mbrojtjes së sistemeve të komunikimit.

Kërcënimet që rrjedhin nga krimi kibernetik nuk janë të vogla, por shumë të mëdha, aq më tepër në kohën kur teknologjia ka hyrë gjithkund. Shembujt përfshijnë dhunën seksuale në internet ndaj fëmijëve, ndaj të cilës nuk e përjashtoj që jemi absolutisht të gjithë të ndjeshëm, por ama ka edhe shkelje të tjera, të cilat duken më të holla, por pesha e rëndësisë së tyre nuk është e vogël: shkeljet kundër dinjitetit, kundër integritetit të individëve, kundër të dhënave, të cilat nevojiten të ngelen domeni i shtetit.

Veçanërisht në vitin 2020 dhe në vitin 2021, gjatë pandemisë së Covid-2019, vendet konstatuan krime shumë të rëndësishme kibernetike, duke përfshirë sulme ndaj spitaleve, ndaj institucioneve mjekësore që zhvilluan vaksina kundër virusit, shpërdorim të emrave të domeneve për të promovuar vaksina, trajtime

dhe kura të rreme dhe lloje të tjera të veprimtarive mashtruese. Unë e solla këtë në vëmendje, sepse ky ka qenë edhe justifikimi publik i hartuesve të protokollit të dytë shtesë të Konventës.

Meqenëse çdo vend ka rregullat e veta për mbrojtjen e të dhënave që konsiderohen të mbrojtura nga ligje të ndryshme të brendshme dhe ndërkombëtare, sigurisht që kjo ka qenë një barrierë për vendet që të zbulojnë krime, të cilat kryhen online dhe të ashtuquajturat krime kibernetike. Kështu që, ishte nevojshme të hartohej një protokoll i tillë, i cili të mundësojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve për sigurimin e të gjitha provave të ashtuquajtura prova elektronike. Konventa, së bashku me të edhe protokollin i dytë shtesë, mbështetet edhe nga një instrument që Këshilli i Europës ka ofruar, siç është Zyra e Programit për Krimin Kibernetik, në Bukuresht, Rumani. Kjo zyrë presupozohet të ndihmojë të gjitha vendet për zbatimin e konventës dhe për sigurimin e të ashtuquajturit bashkëpunim ndërkombëtar.

Informacioni i abonentit është një nga ato informacione që nuk merret lehtësisht, ndonjëherë edhe brenda vendit, sikundër është shumë e vështirë që ky informacion të sigurohet nga vende të tjera. Të dhënat e trafikut kërkohen shpesh në hetimet penale dhe zbulimi i tyre i shpejtë do të mund të ndikonte në zbulimin e hakeruesve dhe në sigurimin e mbrojtjes së informacioneve tona të komunikimit.

Miratimi i këtij protokollin siguron që informacione të tilla, të vështira për t'u aksesuar deri më sot, të merren. Ndërhyrja ime ishte për të tërhequr vëmendjen në këtë pikë për rëndësinë që ka zbatimi dhe miratimi i këtij protokollin të dytë shtesë së bashku me ligjin "Për informacionin e klasifikuar", të cilin shpresoj ta diskutojmë në seancën e radhës plenare, sepse janë të dy projekte të rëndësishme, të cilët duhet të konsiderohen si përgjigje e shpejtë e qeverisë edhe ndaj një sulmi që shumëkush mund ta ketë konsideruar të vogël, por nuk është kështu. Janë sulme të kryera nga hakera që nuk mund të merren kaq lehtë. Asistenca e FBI-së dhe Microsoft-it ka qenë veçanërisht e rëndësishme për të mënjanuar një pjesë të dhënash, por ndërkohë unë besoj fort që edhe veprimi i organeve proceduese, bazuar në konventë, bazuar në protokollin e dytë shtesë dhe në ligjin "Për informacionin e klasifikuar" do të mund të na çojë në rezultate të shpejta të një hetimi dhe natyrisht shpresoj që të kemi edhe një sanksionim të autorëve të këtij krimi ndaj sistemeve tona të komunikimit! Faleminderit!